

DEMOKRACIA E GJYMTUAR

Dialektika Pozitë - Opozitë

I intervistuar nga një gazetar i RAI-t, mbas shpalljes së sondazheve në zgjedhjet lokale të 16 nëntorit në Itali, Massimo Cacciari, filozof, profesor estetike dhe kryetar bashkie i Venecias, i cili bashkë me koalicionin e qendrës së majtë kishte fituar mbi 60% të votave, shprehej: "Janë të dhëna tragjike e uroj që të mos konfirmohen. Kjo do të thotë se zgjedhësit nuk kanë pikë referimi të besueshme në qendrën e djathtë. Problemi nuk është tek Venecia, është çështje nacionale ...Demokracia mbahet në ekuilibrin e dy peshave, nuk është hegjemoni ... Të dhënat që dalin nga këto zgjedhje janë të rënda sepse dëshmojnë që demokracia jonë është një demokraci topalle."

Megjithëse dihet diferenca që ndan realitetin italian nga ai shqiptar, deklarata e Cacciarit nuk ka sesi të mos i kujtojë lexuesit shqiptarë se ka shtatë vjet që politika shqiptare përballet me këtë handicap.

Demokracia shqiptare u hodh në këto vite nga një 70 përqindësh, pra nga një teprim në tjetrin, pa u shoqëruar me as më të voglin reflektim nga ana e fitimtarëve, të cilët deklarorin se s'kishin të ngopur ta mundnin kundërshtarin thellë e më thellë.

E dalë nga një periudhë 50 vjeçarë ku kundërshtari politik cilësohej armik i popullit, politika shqiptare nuk diti të emancipohet në masën që të shihte tek opozita këmbën tjetër në të cilën mbahet demokracia e një vendi. Mos konsiderimi i opozitës si institucion bazë i demokracisë politike, por si një e keqe që mundësisht duhej zhdukur një herë e mirë e me çdo mjet, bëri që klimës politike shqiptare t'i mungonte dendur fryma kon-

Editorial

struktive. Pozita fitimtare e 92-shit filloi ta përdorte pushtetin më tepër për të paralizuar opozitën, sesa për të luftuar komunizmin si sistem, si metodë e si mentalitet. E ndërkohë që komunizmi goditej me bomba demagogjike e përdorej si gogol, përgjegjësit kryesorë të krimeve komuniste në Shqipëri bridhnin rrugëve, ose dënoheshin për kafe e biskota. Nga ana tjetër, opozita e majtë shqiptare përfaqësonte vërtetë mbeturinën e koncentruar të Partisë së Punës, së cilës nuk i vinte fort përdorësh të luante rol konstruktiv në ndërtimin e një shteti demokratik. E megjithatë duhej kuptuar se donim s'donim ishim të obliguar ta ndërtonim bashkë Shqipërinë e nuk mund të ecnim përpara duke e shkatërruar njëri-tjetrin, por vetëm duke luajtur nën rregullat e reja të demokracisë, secili në vendin e vet, pa patur nevojë për koalicione e pajtime të sforcuara.

Kuptimi i demokracisë si triumf i antikomunizmit e i antikomunistëve (ndonëse disa prej tyre ish-komunistë) e jo si një sistem rregullash ku secili ka hapësirën që i takon, e gjymtoi rëndë funksionimin e dialektikës pozitive-opozitive në Shqipëri. Ky handicap gjeti shprehjen e vet më të egër me 26 maj të 1996-ës. Mbas kësaj date nuk mund të flitet për kurrfarë raporti institucional mes pozitës e opozitës, pasi çdo gjë kaloi në rrugë ku gëluan demagogjia, rrëmuja, dhuna, banditizmi e krimi.

Rezultatet tashmë dihen, por sëmundja nuk i është hequr akoma shtetit e politikës shqiptare. Votimet e fundit të zhvilluara nën krisma armësh e përmbysën raportin pozitiv-opozitiv nga njëra anë në tjetrën duke e lënë të hapur rrezikun për revansh e hegjemoni të njëres palë në dëm të tjetrës e për rrjedhojë në dëm të vetë demokracisë.

Shqetësimi rritet kur mendon se një pjesë e madhe nga klasa që qeveris sot Shqipërinë, në rastin më të mirë, i ka akoma duart e skuqura nga duartrokjet për diktatorin në kongreset e Partisë së Punës. Në këtë situatë, demokracia shqiptare ka vetëm një shans e ai është forcimi e konsolidimi i opozitës. Por që të realizohet kjo, duhet recituar së pari e famshmja "mea culpa" e duhen hapur dyert për njerëz të rinj, të dijsëm e me moral të ri. Një opozitë e dobët, llafazane e rrugaçe, viktimë e personazheve të demoduar dhe e një retorike boshe nuk i duhet askujt.

Editorial

Fenomeni Shkodër

Shkodra është sot një qytet i rëndomtë i Shqipërisë së varfër e gjysëm të shkatërruar. Jeta sociale e këtij qyteti llaçarë ndërruar thashetheme meqanëse e kacagjelosje boshe për një të kaluar që mezi duket mes gërmadhave të sotme. E megjithatë, ka një pikë ku Shkodra megjithë plehun që e mbulon përbën një fenomen shembullor për Shqipërinë e sotme. Në të gjitha takimet elektorale të kohëve të fundit, Shkodra ka dëshmuar një tendencë të fortë ekuilibruese e shpesh kundër rrjedhe. Në zgjedhjet e '91 Shkodra votoi për Partinë Demokratike në një kohë që pjesa tjetër e Shqipërisë votoi me 70% të vendeve në parlament, Partinë e Punës të Ramiz Alisë. Me 1992 Shkodra përsëriti votën e saj duke realizuar fitoren e forcave antikomuniste. Votimet e majit të '96 falë manipulimeve nuk mund të shërbejnë si test i vërtetë, por tashmë, duhet reagimi që Shkodra i bëri në tetor pushtetit të pakufizuar që PD mori nga vota e majit. Votimi për kryetarin e bashkisë të kandiduar nga e Djathta shkodrane nuk mund të shpëtojë nga kundërshtimi që Shkodra i bënte hegjemonisë së pushtetit që po merrte formën e një regjimi. Më 1997 Shkodra përsëri dëshmoi sens ekuilibri. Ajo në turin e parë i kaloi pothuajse të gjitha zonat në balotazh, e më pas, në turin e dytë, i kundërqëndroi inercisë për nga e majta që kishte marrë shumica e elektoratit, duke i dhënë pak frymëmarrje minorancës së dërrmuar që po dilte nga këto zgjedhje.

Siç duket, tendenca për të ruajtur sensin e masës, dëshmi kjo pa dyshim e një emancipimi civil, ka dominuar mbi banalitetin e sipërfaqes së fytyrës së këtij qyteti duke shënuar ndoshta një ndër të paktat rreze shprese për shëndetin e ardhshëm të demokracisë shqiptare.

Pazari i ulët i jetës politike shqiptare

Përballë realitetit të përditshëm të jetës shqiptare, shqetësimi për një raport harmonik mes pozitës e opozitës, mes së majtës e së djathtës e leximi i votës së Shkodrës nën dritën e kësaj problematike, ka rrezik të ngajë i sajuar, ose të paktën disi abstrakt.

Editorial

Jeta politike në Shqipëri më shumë se nën trysninë e dialektikës pozitë-opozitë apo e majtë e djathtë, zhvillohet nën presionin e mlllefeve personale e komplekseve, interesave për t'u pasuruar e pazarleqeve mes klaneve, naivitetit e djallëzive, injorancës e brutalitetit.

Veç kësaj, politika shqiptare karakterizohet nga një kompleks i fortë inferioriteti ndaj çdo këshille apo presioni që vjen nga jashtë duke reaguuar herë me nervozizëm e herë me përlulësi të tepruar. Në fakt ka disa dekada që ajo, ose u lëpin këmbët të huajve, ose ia përplas në fytyrë duke korrur në të dyja rastet rezultate të vajtueshme. Rastet jo të pakta të rrahjeve banditeske të politikanëve apo njerëzve që shprehnin opinione kundërshtuese politike, bllokimet e rrugëve, ndërshymjet e policisë mbi politikanë që manifestojnë paqësisht, zvarritja e Blendi Gonxhes në sheshin Skëndërbej, rrahja dhe futja e preshit në gojën e Tritan Shehut, atentati ndaj Berishës deri tek plumbat mbi Azem Hajdarin në dyert e atij që duhej të ishte tempulli i demokracisë, të gjitha flasin për një nivel tepër të ulët të pazarit politik shqiptar. Këto ndoshta përbëjnë anën tragjike, por ka në jetën politike shqiptare edhe doza jo të pakta komiciteti që burojnë nga mungesa e seriozitetit dhe injoranca me të cilën është e veshur një pjesë jo dhe aq e vogël e klasës politike shqiptare. Mbjaj mend një fushatë elektorale të së Djathtës ku kandidati për deputet i pre-zantohej elektoratit duke i thënë se dinte italisht si me shkrim ashtu edhe me gojë.

Katolikët në politikë

Problemi i impenjimit të katolikëve në politikën shqiptare, megjithëse është rrahur si ndër leksione teologësh e si në debate zyresh partiake, nuk ka gjetur deri më sot asnjë rezultat serioz. Të përjashtuar totalisht e për shumë kohë nga jeta politike, katolikët u gjendën disi të hutuar psikologjikisht e të papërgatitur profesionalisht për t'u marrë me politikë. Ndërkohë që dyert e jetës politike shqiptare u hapën nga ata që për gjysëm shekulli ia mbanin çelësat, vendet u zunë shpejt e shpejt nga më të "shkathët", duke i lënë shumë njerëz të ndershëm të breheshin ndër dyshime e skrupuj.

Editorial

Megjithatë, problemi kryesor ndoshta nuk qëndron tek sasia e pjesëmarrjes në strukturat politike e administrative të shtetit të ri shqiptar, sa tek kontributi cilësor në emancipimin e jetës politike shqiptare dhe në krijimin e një morali të ri politik. Pikërisht ky kontribut ka munguar. Me përjashtim të slloganit për dimensione njerëzore të politikës që u përdor në fillim të viteve 90 e ndonjë fjalë në parlament kundër abortit, asgjë nuk u përcoll nga principet sociale të kristianizmit në politikën shqiptare.

Ajo që nuk u kuptua mirë mesa duket ishte se katolikët nuk duhej të bëheshin ministra, deputetë, kryetarë bashkishë apo partishë për të dalë në vitrinë si përfaqësues të komunitetit religjioz të cilit i përkitnin, por për të mbrojtur e aplikuar disa principe e metoda që duke i përkitur kulturës kristiane janë njëkohësisht universale. Në diskutimin e Papa Palit VI në asamblenë e OKB-së (4.10.1965) shpaloset më së miri pikësynimi i kishës për të kontribuar në ndërtimin e një strukture shoqërore në pluralizëm (ku njëri dallohet prej tjetrit) në unitet bashkëpunues (njëra bashkë me tjetrin) në barazi (jo njëri sipër tjetrit) në paqe (jo njëri kundër tjetrit) e në solidaritet (njëri për tjetrin). Që këto principe të kishës të bëhen realitet duhet një impenjim i laikëve të cilët harxhojnë pasionin, dijet, durimin, vullnetin e kurajon në aplikimin e tyre në jetën politike. Jashtë luftës për principe, impenjimi i katolikëve në politikë do të degradonte në përpjekje për t'u dhënë një poltron Palit e Pjetrit që këta pastaj të merrnin në punë Ndocin, Kolën e Prendën.

Sigurisht që problemi i përfaqësimit, veçanërisht pas një kohe të gjatë përjashtimi, ka rëndësinë e vet, por ai nuk mund ta ezarurojë problemin e impenjimit të katolikëve në jetën politike e sociale.

Nga ana tjetër duhet theksuar se impenjimi politik nuk realizohet vetëm nëpërmjet partive e aq më pak nëpërmjet një partie të vetme me orientim kristian, e cila në realitetin shqiptar nuk ka gjasa të jetë e suksesshme. Gjithashtu, ky impenjim nuk ka si qëllim të vetin themelorr marrjen e pushtetit, por afirmimin e vlerave, ndaj veç aktivizimit partiak mund të ketë edhe shumë rrugë të tjera nëpërmjet të cilave katolikët mund ta afirmojnë qëndrimin e tyre. Një rol të veçantë mund të luajnë shtypi ose shoqatat apo klubet e ndryshme me orientim kristian.

Editorial

Në shoqëritë e përparuara sot roli i shoqatave po bëhet gjithnjë e më i madh, por janë ata që kontribuojnë më së tepërmi në ndërtimin e shoqërisë civile.

Organizma të tillë përveçse në afirmimin e vlerave demokratike e mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, mund të shërbenin edhe si moderatorë në momente acarimesh mes partive e kampeve politike kundërshtarë, duke evituar ekstremizimet e pozicioneve që në Shqipëri kanë çuar në rezultate shkatërrimtare. Nga ana tjetër, shtypi mund të shërbejë fort mirë qoftë si tribunë për të shpallur principet themelore, qoftë si arenë për debat, opinione e analiza. Por nga ana tjetër duhet theksuar se roli emancipues që duhet dhe pritet të luajë komuniteti katolik në jetën sociale e politike të vendit përjashton çdo hipotezë integralizmi e fundamentalizmi katolik (pasi nuk ekziston vetëm fundamentalizmi islamik), i cili nuk do të realizonte asgjë veç ndërlikimeve të rrezikshme për të ardhmen e raporteve fetare në Shqipëri. Megjithatë një hipotezë e tillë nuk ka gjasa të bëhet realitet.

Sot komuniteti katolik nuk mund të qëndrojë indiferent përballë gjymtimeve të demokracisë shqiptare. Ai duhet të artikulojë qëndrimin e vet e të kontribuojë në shërimin e kapërcimin e tyre. Në këtë mënyrë ai nuk do t'i krenohet vetëm së shkuarës së vet, por edhe të sotmes e, çka është më e rëndësishme, të ardhmes.

Adrian Paci